



Shqipëria në Zemër të Agjendës së NATO-s: Ministri Vengu në Ministerialin e Mbrojtjes në Bruksel



» faqe 3



GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI MORI PJESË NË DITËN E VIZITORËVE TË SHQUAR TË STËRVITJES “DEFENDER EUROPE-25” NË GJAKOVË, KOSOVË

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtnant Arben Kingji, mori pjesë në Ditën e Vizitorëve të Shquar të Stërvitjes shumëkombëshe “Defender Europe - 25” (DE/IR25), e cila u zhvillua në poligonin e stërvitjes në Babaj të Bokës në Gjakovë, Kosovë. Në këtë aktivitet të pranishëm ishin udhëheqësit më të lartë të shtetit të Kosovës...



faqe 2



DEFENDER EUROPE NË SHQIPËRI (2021, 2023, 2025)

Shqipëria pati nderin të presë për herë të tretë stërvitjen më të madhe ushtarake në Europë, dhe ky është privilegj i posaçëm për FASH-të, të cilët janë pritës dhe pjesëmarrës të kësaj stërvitjeje, që për herë të tretë vë në pah përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve tona ushtarake, falë dhe mbështetjes së paçmuar të vendeve aleate të NATO-s dhe SHBA-ve. Zhvillimi për herë të tretë në Shqipëri i stërvitjes më të madhe...



faqe 4



NË GAZA NUK PO VRITEN VETËM NJERËZ, PO VRITET NDËRGJEGJJA E BOTËS

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Gjenocid apo Shfarosje në Gaza?! Një krizë humanitare me përmasa historike. Që nga fillimi i ofensivës izraelite mbi Rripin e Gazës në tetor 2023, bota është përballur me një nga krizat më të rënda humanitare dhe ushtarake të dekadave të fundit. Mbi 54,000 palestinezë janë vrarë, pjesa dërrmuese...



faqe 6

Shqipëria themelon Komandën e Kibernetikës dhe Ndërlidhjes, ministri Vengu: Një Hap Historik drejt Modernizimit të Mbrojtjes Kombëtare

Në një ceremoni solemne, u zyrtarizua krijimi i Komandës së Kibernetikës dhe Ndërlidhjes së Forcave të Armatosura, e cila prej këtij momenti do të operojë si një njësi e veçantë strukturore brenda Forcave të Armatosura, në përputhje me zhvillimet bashkëkohore të sigurisë dhe nevojat strategjike të vendit. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, e ngarkuara me punë e SHBA-së në Shqipëri znj. Nancy VanHorn, gjeneralmajor John Phillips si dhe përfaqësues të lartë të Forcave të Armatosura, atashë ushtarakë të akredituar në vendin tonë dhe të ftuar të tjerë.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes Vengu e cilësoi krijimin e Komandës së Kibernetikës dhe Ndërlidhjes si një hap historik drejt modernizimit të strukturave ushtarake dhe rritjes së sigurisë kombëtare në një mjedis gjithnjë e më të digjitalizuar: “Sulmet kibernetike të vitit 2022 ndaj Shqipërisë, shërbyen si një kujtesë e fuqishme se, në një botë gjithnjë e më të digjitalizuar, mbrojtja e hapësirës kibernetike është po aq e rëndësishme sa mbrojtja e integritetit territorial të vendit.


Këto zhvillime, të mbështetura edhe në përvojat e tjera të NATO-s, e bënë të domosdoshëm dhe krejt të natyrshme në fakt krijimin e Komandës Kibernetike dhe Ndërlidhjes, të cilën themelojmë sot.

Jo vetëm e natyrshme, sepse na duhet më shumë ndërveprim mes forcave operationale që ndërmarrin veprimtari që lidhen me mbrojtjen kibernetike dhe me komunikimin digjital, e natyrshme, sepse ky është një domen ku padyshim bashkëpunimi mes komponentit ushtarak dhe komponentit civil është ndoshta çelësi i suksesit. Krijimi i kësaj komande, përbën një hap historik dhe thekson edhe njëherë angazhimin e Shqipërisë në modernizimin e infrastrukturës së saj të sigurisë kibernetike, duke konfirmuar rolin tonë gjithnjë e më aktiv në arkitekturën rajonale dhe brenda aleancës për sa i përket politikave të sigurisë kibernetike”, - theksoi ministri Vengu.

Sipas ministrit të Mbrojtjes, krijimi i kësaj Komande vjen gjithashtu, pas një sërë hapash të ndërmarrja gjatë 5-vjeçarit të fundit nën tutelën, nën mbështetjen, nën trajnimin e partnerëve tanë, aleatëve tanë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

“Kalimi në nivel komande do të sjellë një sërë avantazhesh të rëndësishme, në drejtim të rritjes së efikasitetit operativ dhe të kapaciteteve të mbrojtjes kibernetike dhe komunikimit të sigurt”, - nënvizoi ministri Vengu.

Gjeneralmajor John Phillips, drejtor i Njësisë Kibernetike në Komandën Evropiane të SHBA-ve vlerësoi lart rolin e Shqipërisë si një partnere e besueshme dhe e angazhuar në kuadër të aleancës: “Shqipëria ka treguar angazhim të palëkundur si një aleate e denjë e NATO-s dhe krijimi i kësaj komande është një hap domethënës në forcimin e arkitekturës së përbashkët të mbrojtjes kibernetike”, - u shpreh



gjeneralmajor Phillips.

Nga ana e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, u shpreh: “Krijimi i Komandës së Kibernetikës dhe Ndërlidhjes si pjesë e përmirësimeve strukturore të Forcave të Armatosura për adresim më të mirë të sfidave të mjedisit të sigurisë është një qasje proaktive ndaj karakterit të ndryshueshëm të konflikteve moderne”.

Ai shtoi se, në këtë mjedis të ri operativ, kundërshtarët janë gjithnjë e më të padukshëm dhe, duke shfrytëzuar çdo mundësi që ofron teknologjia, synojnë ndërhyrjen në sistemet e komunikimit, dëmtimin e infrastrukturës kritike, nxitjen e dezinformimit dhe konflikteve, shpesh pa shkreput asnjë armë të vetme.

Komandanti i ri i Komandës së Kibernetikës dhe Ndërlidhjes së FA-së, gjeneral brigade Hamdi Doda u shpreh i vendosur për ngritjen e një strukture moderne dhe efektive, që do të garantojë sigurinë dhe ndërveprimin në të gjitha nivelet e komandës dhe kontrollit.

Ceremonia u përmbyll me një moment simbolik, ku gjenerallejtënant Kingji i dorëzoi flamurin e strukturës së re ushtarake komandantit të saj, gjeneral brigade Hamdi Doda, duke zyrtarizuar kështu nisjen e funksionimit të kësaj komande të re në përbërje të Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Gjenerallejtënant Arben Kingji mori pjesë në Ditën e Vizitorëve të Shquar të stërvitjes “Defender Europe-25” në Gjakovë, Kosovë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në Ditën e Vizitorëve të Shquar të stërvitjes shumëkombëshe “Defender Europe - 25” (DE/IR25), e cila u zhvillua në poligonin e stërvitjes në Babaj të Bokës në Gjakovë, Kosovë.

Në këtë aktivitet të pranishëm ishin udhëheqësit më të lartë të shtetit të Kosovës, përfaqësues të trupit diplomatik dhe udhëheqës të lartë ushtarakë ndërkombëtarë.

Pjesëmarrësit në këtë ceremoni fillimisht vizituan Post-Komandën Taktike të Divizionit të 28-të të ushtrisë amerikane, ku u njohën nga afër me zhvillimet e aktiviteteve të stërvitjes DE/IR25 në vendet e rajonit të Ballkanit. Gjatë vizitës në Kontrollin e Lartë të stërvitjes, personalitetet e larta u njohën edhe me rolin e rëndësishëm dhe kontributin e Forcës së Sigurisë së Kosovës si mikpritëse për forcat e dislokuara në Kosovë në kuadër të kësaj stërvitje, duke vlerësuar bashkëpunimin e ngushtë dhe të frytshëm me Divizionin e 28-të të Ushtrisë amerikane.

FARSH merr pjesë në stërvitjen DE/IR25 në Kosovë me trupa EOD dhe oficerë shtabi në Shtabin e Divizionit, ndërkohë që në stërvitjen DE/IR25 që zhvillohet në Shqipëri FARSH drejton Shtabin e Brigadës Shumëkombëshe



si dhe ka angazhuar trupa, mjete, helikopterë dhe anije. Ushtarakët shqiptarë marrin gjithashtu pjesë edhe në stërvitjet IR/DE25 që zhvillohen në Kroaci, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi.

Stërvitja DE/IR25 është një stërvitje shumëkombëshe e organizuar nga Komanda e Forcave Amerikane për Evropën dhe Afrikën, ku testohen dislokimi i forcave, ndërveprimi, si dhe aftësia për t'u përgjigjur ndaj situatave komplekse të sigurisë.



Shqipëria në Zemër të Agjendës së NATO-s: Ministri Vengu në Ministerialin e Mbrojtjes në Bruksel

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, po merr pjesë në Ministerialin e Mbrojtjes së NATO-s, një takim vendimtar që po zhvillohet në selinë qendrore të Aleancës në Bruksel. Ky ministerial përkon me fazën përgatitore të Samitit të NATO-s që do të mbahet në Hagë më 24-26 qershor.

Në këtë takim, ministrat e mbrojtjes po diskutojnë mbi përforcimin e kapaciteteve të Aleancës, modernizimin ushtarak dhe rritjen e angazhimit të shteteve anëtare në kontekstin e sigurisë globale, me theks të veçantë mbi: Rritjen e buxheteve për mbrojtjen në nivelin 5% të PBB-së, si pjesë e një përpjekjeje për të garantuar parandalimin e besueshëm; Objektivat e reja të kapaciteteve, që përfshijnë mbrojtjen ajrore, armatimin me rreze të gjatë dhe formacione tokësore të gatshme për veprim; Mbështetjen për Ukrainën, si pjesë e përkushtimit të NATO-s për stabilitetin në lindje të Evropës.

Ministri Vengu theksoi në Bruksel se Shqipëria është një kontribuuese aktive në sigurinë kolektive, dhe ripërsëriti angazhimin e qeverisë shqiptare për: Rritjen e pranisë në misionin EUFOR-ALTHEA që nga janari 2025; Krijimin e një infrastrukture moderne për vendin pritës, me në fokus Korridorin VIII, që përfshin pikën hyrëse detare në Porto Romano; Forcimin e bashkëpunimit me SHBA-në, Italinë, Francën, Hungarinë dhe Kroacinë në fushën e industrisë së mbrojtjes dhe trajnimit ushtarak.

Në takimet dypalëshe, Ministri Vengu shprehu vlerësime për leadershipin e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, si dhe uroi Sekretarin e ri të Mbrojtjes së SHBA, Pete Hegseth, për marrjen e detyrës së re. Shqipëria vazhdon të jetë një partner i besueshëm dhe aktiv në garantimin e sigurisë në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë.





Kontingjenti XVII EOD, merr detyrën në kuadër të misionit të Prezencës së Përparuar të Përforcuar pas transferimit të komandës dhe autoritetit nga Kontingjenti XVI

Efektivët e Kontingjentit XVI kanë realizuar me sukses detyra të rëndësishme, duke marrë pjesë në stërvitje të tilla si “Resolute Warrior”, “OAK Resolve 25-01”, duke mbështetur me operacione EOD të gjitha njësitë e brigadës shumëkombëshe.

Drejtnesit më të lartë të brigadës shumëkombëshe kanë vlerësuar me certifikata mirënjohje efektivat tanë për profesionalizmin, angazhimin dhe lidhshmërinë e dëshmuar gjatë këtij misioni.

Stafetën e merr tashmë Kontingjenti i XVII, i cili me përkushtim dhe gatishmëri merr përsipër realizimin e detyrave komplekse dhe jetike, që lidhen me ruajtjen e jetës së personelit dhe sigurimin e vijueshmërisë së operacioneve ndërkombëtare.



Forcat Speciale Shqiptare marrin pjesë në “Laufer-25”: Rritje e Kapaciteteve në Kuadër të NATO-s

Efektivë të Regjimentit të Operacioneve Speciale të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë po marrin pjesë në stërvitjen shumëkombëshe “Laufer-25”, e zhvilluar në kuadër të “IMEDIATE RESPONSE 25”, në territorin e Kroacisë, në përbërje të strukturave të vendeve anëtare të NATO-s.

Gjatë këtij angazhimi, janë vënë në zbatim kapacitete bashkëkohore të vëzhgimit dhe grumbullimit të informacionit operacional, duke demonstruar një qasje moderne dhe të integruar në përputhje me standardet e Aleancës. Përdorimi me sukses i mjeteve të teknologjisë së avancuar, në kuadër të skenarëve të parashikuar nga stërvitja, përbën një hap domethënës në konsolidimin e kapaciteteve të Regjimentit.

Përfshirja aktive e efektivëve të Regjimentit të Operacioneve Speciale në këtë aktivitet të nivelit të lartë është dëshmi i përgatitjes profesionale, angazhimit të vazhdueshëm dhe rolit konstruktiv të Forcave të Armatosura në arkitekturën e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare.

Forcat Ajrore shuan zjarret në Darëzezë përmes operacionit ajror

Forcat Ajrore luajtën një rol vendimtar në shuarjen e zjarrit masiv që përfshiu ekonominë pyjore të Darëzezës. Gjatë një operacioni dyditor, dy helikopterë “Black hawk” kryen fluturime intensive, duke shpërndarë mijëra litra ujë mbi vatrat më problematike të flakëve.

Në bashkëpunim të ngushtë me forcat zjarrfikëse tokësore, strukturat vendore dhe strukturave të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, të Mbrojtjes nga Zjarri, ndërhyrja ajrore mundësoi shuarjen e zjarrit në terrene të vështira dhe të paarrishme për mjetet tokësore. Ndërhyrjet e koordinuara siguruan frenimin e përhapjes së flakëve dhe mbrojtjen e një pjese të konsiderueshme të pyjeve, duke konkluduar me shuarjen e zjarrit masiv.

Autoritetet vendore, kanë vlerësuar suksesin e ndërhyrjes dhe kanë bërë thirrje për kujdes të shtuar për të parandaluar zjarre të tilla në të ardhmen.



Angazhimi i Detashmentit të Dronëve në Stërvitjen “DEFENDER EUROPE-25”

Stërvitja shumëkombëshe “Defender Europe – 25”, e cila po zhvillohet në disa vende të Evropës Juglindore, përfshirë Shqipërinë dhe Kosovën, ka shënuar një moment historik jo vetëm për Forcat e Armatosura, por dhe për Forcën Ajrore. Kjo është hera e parë që Detashmenti UAV i Forcës Ajrore shqiptare përdor sistemet e veta të avionëve pa pilot (UAV) në një nivel kaq të avancuar dhe të integruar, duke treguar aftësinë për të përballuar sfidat e një mjedisi kompleks të sigurisë.

Gjatë “Defender Europe – 25”, Detashmenti UAV ka luajtur një rol thelbësor në mbështetjen e operacioneve të përbashkëta me aleatët dhe partnerët ndërkombëtarë. Me përdorimin e UAV-ve, janë realizuar një sërë detyrash të rëndësishme. Përmes zbulimit ajror dhe vëzhgimit taktik, dronët kanë mbledhur informacion në kohë reale mbi lëvizjet e forcave kundërshtare të simuluar dhe kanë monitoruar fushën e betejës, duke ndihmuar në marrjen e vendimeve strategjike.

Një nga funksionet kryesore të UAV-ve ka qenë identifikimi dhe përcaktimi i objektivave për artilerinë dhe forcat e tjera të zjarrit të drejtpërdrejtë. Ky angazhim ka përmirësuar ndjeshëm saktësinë dhe efektivitetin e goditjeve, duke kontribuar në suksesin e skenarëve të stërvitjes. Për më tepër, UAV-të kanë mbikëqyrur lëvizjet e njësisë logjistike, duke siguruar rrugë të sigurta për transportin e furnizimeve dhe përforcimeve.

Një tjetër arritje madhore ka qenë testimi i ndërveprueshmërisë me Brigadën Shumëkombëshe të Jugut. Sistemet UAV janë integruar me platformat e komunikimit dhe komandës të Brigadës, duke siguruar një koordinim të suksesshëm dhe një operacion të përbashkët të sinkronizuar. Ky integrim shënon një hap të rëndësishëm për modernizimin e forcave të armatosura dhe përgatitjen e tyre për sfidat e ardhshme.

“Teknologjia e dronëve është një element thelbësor i modernizimit dhe rritjes së kapaciteteve mbrojtëse të vendit. Përmes përdorimit të teknologjisë së avancuar, po tregojmë aftësinë tonë për të kontribuar në sigurinë rajonale dhe globale”, – vuri në dukje, komandanti i detashmentit, nënkolonel Eljo Buçka.



FORCAT E
Armatosura



DEFENDER
EUROPE
2025



DEFENDER EUROPE 2021

– Fillimi i një epoke të re ushtarake për Shqipërinë

Shqipëria pati nderin të presë për herë të tretë stërvitjen më të madhe ushtarake në Europë, dhe ky është privilegj i posaçëm për FASH-të, të cilët janë pritës dhe pjesëmarrës të kësaj stërvitjeje, që për herë të tretë vë në pah përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve tona ushtarake, falë dhe mbështetjes së paçmuar të vendeve aleate të NATO-s dhe SHBA-ve.

Zhvillimi për herë të tretë në Shqipëri i stërvitjes më të madhe ushtarake në Europë ngarkon vendin tonë jo vetëm me një përgjegjësi të jashtëzakonshme, por vë në dukje përparimin dhe pjekurinë e arritur nga Shqipëria.

Karakteristika: Stërvitja e parë e këtij lloji, ku Shqipëria shërbeu si një nga vendet pritëse, përfshirë mbi 28,000 trupa nga 26 vende.

Theks te operacionet logjistike dhe siguria portuale në Durrës dhe baza të tjera.

Përfitime për Shqipërinë: Vendosja e Shqipërisë si pikë strategjike logjistike për NATO-n në rajon, përmirësimi i infrastrukturës ushtarake dhe civile (porti i Durrësit, rrugë, urë komunikimi).

Rritje e besimit ndërkombëtar për rolin e Shqipërisë si vend aleat i sigurt dhe i besueshëm.

DEFENDER EUROPE 2023

– Thellimi i bashkëpunimit ushtarak dhe teknologjik

Karakteristika: Pjesëmarrje e zgjeruar e forcave tokësore dhe ajrore shqiptare.

Fokus në operacione ndërvepruese, mbrojtje territoriale dhe kundërveprim ndaj kërcënimeve hibride.

Përfitime për Shqipërinë: Trajnimi i Forcave të Armatosura në skenarë të avancuar luftarak dhe operacione ndërkombëtare.

Rritja e ndërveprueshmërisë me ushtritë aleate, duke e bërë Shqipërinë pjesë aktive të planifikimeve strategjike të NATO-s.

Mbështetje teknike dhe trajnime për përdorim të sistemeve moderne të mbikëqyrjes dhe komandës.

DEFENDER EUROPE 2025

– Konsolidimi i rolit strategjik dhe teknologjik të Shqipërisë

Karakteristika: Rreth 28,000 trupa nga 39 vende.

Shqipëria luan rol qendror në fazën “Immediate Response”. Përdorimi për herë të parë i dronëve dhe mjeteve të avancuara të zbulimit.

Përfitime për Shqipërinë: Rritje e kapaciteteve teknologjike të FA-së dhe adaptim me standardet e reja të NATO-s; Forcimi i sigurisë rajonale me Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, si pjesë e bashkëpunimit praktik ushtarak; Rritja e prestigjit të Shqipërisë si vend pritës dhe kontribuues për stabilitetin rajonal.

Çfarë përfaqësojnë këto tre “Defender Europe” për Shqipërinë?

Rritje të sigurisë kombëtare; Trajnime intensive për FA-të; Njohje me teknologji të reja dhe skenarë realë lufte.

Pozicionim strategjik në NATO

Shqipëria është vend kyç për qasje në Detin Adriatik dhe lidhje me Ballkanin Lindor. Këto stërvitje e kanë konsoliduar këtë rol.

DEFENDER EUROPE në Shqipëri (2021, 2023, 2025)



Përfitime ekonomike dhe infrastrukturore

Investime në rrugë, porte, logjistikë dhe bazat ushtarake. Aktivizim ekonomik lokal përmes qarkullimit të trupave dhe përdorimit të resurseve vendore.

Diplomaci ushtarake dhe besueshmëri ndërkombëtare. Shqipëria ka fituar më shumë vëmendje dhe respekt si partnere e besueshme në operacionet ushtarake të NATO-s.

Tre stërvitjet “Defender Europe” në Shqipëri nuk janë thjesht manovra ushtarake, por investime strategjike në të ardhmen e sigurisë, stabilitetit dhe rolit ndërkombëtar të Shqipërisë. Ato kanë forcuar ndjeshëm kapacitetet e brendshme të Forcave të Armatosura dhe kanë ngritur imazhin e vendit në skenën globale.

Shqipëria nuk ka qenë kurrë më lart në nivelin e respektit

ndërkombëtar, dhe tashmë e ulur në tryezën e Këshillit të Sigurimit krah SHBA-ve, ajo merr një profil dhe rol që jo vetëm e ngarkon me përgjegjësi të jashtëzakonshme, por dhe vë në dukje se çfarë përparimi dhe çfarë pjekurie ka arritur vendi ynë.

Zhvillimi i kësaj stërvitjeje është shprehje e unitetit të madh dhe vendosmërisë së palëkundur të komunitetit euro-atlantik për të mbrojtur vlerat dhe parimet mbi të cilat ngrihen shoqëritë tona.

Stërvitjet ‘Defender Europe’ 2021, 2023, 2025, na kujtojnë se pavarësisht gjuhës, flamurit, jemi të lidhur pazgjidhshmërisht nga vlerat dhe parimet që janë të kërcënuara po njësoj për secilin prej nesh.

Të gjithë së bashku jemi të imponuar nga historia dhe ardhmëria që të funksionojmë në unitet të plotë.



Në Gaza nuk po vriten vetëm njerëz, po vritet ndërgjegjja e botës

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Gjenocid apo Shfarosje në Gaza?!

Një krizë humanitare me përmasa historike

Që nga fillimi i ofensivës izraelite mbi Rripin e Gazës në tetor 2023, bota është përballur me një nga krizat më të rënda humanitare dhe ushtarake të dekadave të fundit.

Mbi 54,000 palestinezë janë vvarë, pjesa dërrmuese civilë, gra dhe fëmijë. Po flasim për një realitet ku bombardimet kanë prekur çdo aspekt të jetës civile: spitale, shkolla, zona të banimit dhe qendra humanitare.

Në këtë kontekst të errët, është rritur fuqishëm debati ndërkombëtar rreth pyetjes së dhimbshme: A është ajo që po ndodh në Gaza një gjenocid? Apo kemi të bëjmë me shfarosje të një popullsie?

Çfarë do të thotë “gjenocid”?

Sipas Konventës së OKB-së për Parandalimin dhe Dënimin e Gjenocidit (1948), “gjenocid” nënkupton çdo akt të ndërmarrë me qëllim për të shkatërruar, në tërësi apo pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racor apo fetar.

Në këtë përkufizim përfshihen jo vetëm vrasjet, por edhe krijimi i kushteve që sjellin shkatërrim fizik apo kulturor të grupit.

Argumentet që mbështesin akuzën për gjenocid

Një numër vendesh, organizatash ndërkombëtare dhe personalitete publike, përfshirë Afrikën e Jugut, kanë ngritur padi ndaj Izraelit për gjenocid në Gaza. Në janar 2024, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) vendosi masa të përkohshme, duke i kërkuar Izraelit që të ndërpresë çdo veprim që mund të klasifikohet si gjenocid. Ky vendim nuk e shpalli drejtpërdrejt Izraelin fajtor, por e njohu seriozitetin e akuzave.

Dëshmi që forcojnë akuzat për gjenocid përfshijnë:

- Shkatërrimi i qëllimshëm i spitaleve dhe objekteve civile.
- Deklarata publike nga zyrtarë izraelitë që nxisin shkatërrimin e plotë të Gazës.
- Pengesa e ndihmave humanitare, që çojnë në uri masive dhe kolaps shëndetësor.

Shfarosje apo spastrimi etnik?

Disa ekspertë ndërkombëtarë dhe Komisioneri i OKB-së për të Drejtat e Njeriut kanë përdorur termin “shfarosje” ose “krim kundër njerëzimit”, në vend të fjalës “gjenocid”, për të përshkruar sulmet ndaj civilëve dhe shkallën e zhvendosjes së detyruar të popullsisë.



Rreth 2.3 milionë palestinezë janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre, duke përbërë një pastrim etnik de facto, të ngjashëm me rastet historike në Bosnje dhe Ruandë.

Justifikimi i Izraelit dhe kundërshtimet

Nga ana tjetër, Izraeli e refuzon kategorikisht çdo akuzë për gjenocid, duke pretenduar se është në një luftë të drejtë kundër Hamasit pas sulmit të 7 tetorit 2023, kur mbi 1,200 izraelitë u vranë dhe u morën pengje.

Qeveria izraelite thekson se Hamas përdor civilët si mburoja njerëzore dhe se objektivat ushtarake janë të ligjshme. Megjithatë, proporcionaliteti dhe diskriminimi mes objektivave ushtarake dhe civile janë në thelb të ligjit ndërkombëtar humanitar – dhe këtu lind pyetja e drejtë: A mund të justifikohet vrasja e dhjetëra mijëra civilëve me luftën kundër një organizate terroriste?

Shtetet që kërkojnë ndërprerjen e operacioneve

Përveç Afrikës së Jugut, vende si Kolumbia, Turqia, Bolivia dhe Irlanda kanë kërkuar ndaljen e operacioneve ushtarake

dhe i kanë ndërprerë marrëdhëniet diplomatike me Izraelin. Opinionet publike në shumë vende të Evropës janë kthyer kundër veprimeve të Izraelit, me protesta masive që kërkojnë përgjegjësi ligjore dhe morale.

Drejtësia ndërkombëtare në provë

Kjo krizë ka vendosur në sprovë serioze sistemin ndërkombëtar të drejtësisë. Nëse GJND vendos që Izraeli ka kryer gjenocid, pasojat do të jenë historike – jo vetëm për rajonin, por për të gjithë rendin ndërkombëtar ligjor.

Por një vendim i tillë kërkon vite, dokumentim të thelluar dhe presion politik nga të gjitha anët.

Qëllimi nuk është vetëm të përcaktojmë një emër

Në thelb, pyetja nuk është vetëm “a është kjo një shfarosje apo gjenocid?”. Pyetja më e madhe është: A do të veprojë bota, kur një popull i tërë po zhduket para syve tanë?

Nëse fjalët “asnjëherë më” kanë kuptim, atëherë ato duhet të vlejnë për Gazën – tani. Jo nesër, jo pas një raporti të OKB-së. Historia do të na gjykojë sipas veprimeve që bëjmë sot, jo sipas definicioneve juridike që përdorim.

Një thirrje për ndërgjegje:

Gaza po shuhet – njerëzimi po dështon

Nën gërmadha nuk ndodhen vetëm trupat e pajetë të fëmijëve, por edhe heshtja jonë. Heshtja e kombeve, e udhëheqësve, e popujve që dikur betoheshin “kurrë më”.

Sa jetë duhet të shuhet që të quhet gjenocid? Sa foshnja duhet të mos kenë qumësht, sa nëna të qajnë mbi trupat e fëmijëve të tyre, sa qytete të rrënohen që bota të kuptojë se kjo nuk është më “mbrojtje”, por shkatërrim sistematik?

Gaza nuk ka më spitale, por nuk ka më as zëra që të qajnë.

Të gjithë janë lodhur. Por një popull që po shuhet nuk ka luksin të lodhet nga dhimbja e vet. Sot nuk është më çështje feje, kombësie apo politike, është një çështje e thjeshtë njerëzore: A jemi ende njerëz?

Nëse heshtim tani, i kemi dhënë fund të drejtës për të folur nesër. Sepse sot, përballë një gjenocidi të transmetuar drejtpërdrejt, bota nuk mund të thotë më “nuk e dinim”.

Mos prisni të ndalet bomba e fundit. Mos prisni të numërohen të gjitha viktimat. Ngrihuni tani, jo për palestinezët, por për njerëzimin. Sepse, në Gaza, nuk po vriten vetëm ata, po vdesim të gjithë, pak nga pak, nga heshtja.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Me ndryshimin e sistemit politik, hapja e Shqipërisë me Europën ka bërë të mundur lëvizjen e lirë, e cila na ka krijuar mundësinë të shijojmë bukuritë natyrore dhe arkitektonike të këtyre vendeve, kur përpara 30 vitesh ishte thjesht një utopi. Por mesa duket për një pjesë të mirë të shqiptarëve, duket se këto zhvillime janë të krijuara vetëm për ato vende dhe nuk munden t'i sjellin me vete në 'valixhen' e tyre teksa kthehen në Shqipëri. Një 'çudi europjane' janë dhe bibliotekat e rrugës, deri këtu nuk kemi ndryshim, sepse edhe ne në format primitiv 'tregtojmë' libra në rrugë, ajo që bën diferencën është se në bibliotekat europiane, të rinj dhe të reja, fëmijë dhe të moshuar qëndrojnë në radhë për të marrë librin e tyre të preferuar. Ndërsa në Shqipëri, grup-mosha të ndryshme, reagimin e vetëm indiferent e kanë pikërisht kur kalojnë mbi trotualet e mbushur me libra.

Biblioteka pa mure, një realitet europian dhe një mundësi e humbur shqiptare

Në një shoqëri që ecën me ritme të shpejta drejt modernizimit dhe globalizimit, kultura e leximit mbetet një nga shtyllat më të rëndësishme të zhvillimit shpirtëror, intelektual dhe moral të individit. Një shembull i jashtëzakonshëm i kësaj kulture mund të gjendet në Gjermani, Angli, Itali, ku në qytete të mëdha dhe të vogla, janë të pranishme të ashtuquajturat biblioteka të rrugëve – një ide e thjeshtë, por e thellë në simbolikën dhe funksionin e saj.

Këto biblioteka janë dollapë ose struktura të vogla të vendosura në vende publike, në trotuare, parqe, stacione metroje, afër shkollave apo edhe pranë ndërtesave të banimit, ku qytetarët mund të marrin një libër për të lexuar dhe të lënë një tjetër në vend të tij. Janë të hapura për të gjithë, pa ndonjë rregull burokratik, pa regjistrim, pa pagesë. Çdokush mund të lexojë, pavarësisht moshës, profesionit apo statusit ekonomik. Vetë koncepti përfaqëson besimin në qytetarët dhe në fuqinë e dijes.

Në pamje të parë, kjo mund të duket një nismë modeste, por në të vërtetë ajo është shprehje e një shoqërie që ka vendosur leximin në qendër të jetës së përditshme. Kur kalon pranë një biblioteke të rrugës në Berlin, Londër apo Romë, shikon njerëz që ndalojnë për të parë se çfarë librash ka, prindër që i mësojnë fëmijët të zgjedhin tituj, të rinj që gjejnë aty një alternativë të shëndetshme ndaj ekranit të celularit.

Europianët nuk e kanë humbur kontaktin me librin edhe pse jetojnë në një epokë digjitale. Përkundrazi, leximi është integruar në mënyrë organike në jetën urbane dhe individuale.

Kontrasti me Shqipërinë: mungesa e kulturës së leximit

Për fat të keq, kur e krahasojmë këtë realitet me atë të Shqipërisë, kontrasti është i thellë dhe shqetësues. Në vendin tonë, leximi është gjithnjë e më shumë në rënie, jo vetëm si statistikë, por si vlerë shoqërore. Ndonëse në rrjete sociale, shumë njerëz postojnë citime librash apo flasin për letërsi, kjo është shpesh vetëm një fasadë. Realiteti tregon një tjetër tablo: bibliotekat publike janë të varfra, të neglizhuara, me fonde të vjetruara dhe pak të frekuentuara. Libraritë private janë përherë e më pak të vizituara dhe librat shihen si mallra luksi, të paarritshëm për shumë familje me të ardhura të ulëta.

Në sistemin arsimor, leximi shpesh reduktohet në një detyrim shkollor, jo në një kënaqësi apo nevojë personale. Shumë nxënës mësohen të lexojnë për t'u testuar, jo për të kuptuar botën apo për t'u formuar si individë të pavarur në mendim. Kjo i bën ata të zhvillojnë një refuzim të heshtur dhe të qëndrueshëm ndaj librit, i cili shpesh zgjat gjatë gjithë jetës së tyre.

Kjo mungesë e kulturës lexuese nuk është thjesht një çështje personale. Ajo është pasojë e një sistemi të tërë që nuk i jep prioritet zhvillimit kulturor dhe edukativ. Politikat arsimore shpesh janë të papërqendruara, promovimi i leximit është i dobët ose inekzistent, dhe mungojnë nismat kreative që mund ta sjellin librin më afër qytetarëve – siç janë bibliotekat e rrugëve, festivalet e leximit, panaireset e librave në shkolla, leximi në natyrë, etj.

Pse funksionon në Europë, dhe pse dështon në Shqipëri?

Mentaliteti shoqëror dhe ndjeshmëria ndaj librit - Në Europë, që

Kur libri gjendet në rrugë dhe nuk humbet, shembulli europian për një Shqipëri që nuk lexon



në moshë të hershme, fëmijët mësohen të kenë kontakt me librin. Familjet lexojnë me fëmijët, kopshtet kanë lexime të përditshme, dhe mësuesit e paraqesin librin si një shok të përhershëm. Në Shqipëri, në shumë familje nuk ka libra fare në shtëpi dhe nuk ka një traditë të leximit si aktivitet familjar.

Infrastruktura publike - Bibliotekat në këto vende janë të shumta, të pasura me tituj dhe të aksesueshme nga të gjithë. Në Shqipëri, shumë qytete të vogla kanë vetëm një bibliotekë, shpesh të pa pajisur dhe me staf të pakualifikuar. Biblioteka e shkollës shpesh është formale, ekziston vetëm në letër.

Gjithashtu leximi promovohet nga institucionet, nga liderët publikë, nga media. Leximi është pjesë e identitetit kombëtar. Në Shqipëri, mungon frymëzimi. Shpesh janë pak individë entuziastë që nisin nisma të vogla, por pa mbështetje institucionale ato shuhen shpejt.

Çfarë mund të marrim nga këto vende veç 'relaksit'?

Bibliotekat e rrugëve nuk janë thjesht një risi arkitektonike apo një detaj simpatik urban. Ato janë simbol i një shoqërie që e vlerëson dijen si pasuri kolektive.

Shqipëria ka shumë për të mësuar nga ky model, por ndryshimi

nuk do të vijë vetvetiu. Duhet një strategji kombëtare për rikthimin e leximit si prioritet kombëtar, i cili duhet të përfshijë:

- Ndërtimin dhe modernizimin e bibliotekave publike dhe shkollore
- Nisma komunitare për ndarjen e librave (edhe bibliotekat e rrugëve si projekte pilot)
- Promovimi i leximit në media dhe rrjete sociale
- Përshtatja e programeve shkollore për të nxitur leximin kritik dhe kreativ
- Përfshirja e prindërve në edukimin kulturor të fëmijëve

Biblioteka e rrugëve në Gjermani është një dritare e hapur drejt një bote ku libri ka vendin që i takon, në zemër të jetës publike dhe private. Ajo dëshmon se kur leximi kultivohet që nga fëmijëria, kur institucioni beson te qytetari, dhe kur shoqëria e konsideron dijen si investim, atëherë krijohet një kulturë që nuk shuhet.

Shqipëria ka nevojë për më shumë libra në duar, në parqe, në shkolla, në shtëpi. Por mbi të gjitha, ka nevojë për dashuri për leximin, një dashuri që nuk mësohet me detyrim, por me shembull, me hapësira të aksesueshme, me nisma që frymëzojnë dhe me besim se libri është çelësi i emancipimit dhe progresit.



KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

Nga Zjarri i Luftës në Përqafimin e Beratit: Refugjatët Kosovarë në 1999

Lufta e Kosovës, shpërndarja e shqiptarëve të Kosovës në rrethin e Beratit, prill 1999

Po vjen 11 qershori, ajo ditë e bekuar, kur më në fund serbët morën nga sytë këmbët dhe Kosova jonë, plaga e madhe e shqiptarisë, filloi të mbyllej më në fund!

Kosova e lirë! Ëndrra e madhe e një populli, e një kombi, u bë e vërtetë! Iu dha fund një padrejtësie më se shekullore, një krimi shtetëror edhe me frymëzim dhe mbështetje të Rusisë dhe bekimin e fuqive të mëdha, do t'i jepej fund një plani kriminal të përpunuar dhe realizuar nga mendjet më të errëta të një grupi akademikësh e shtetarësh serbë që përpunuan me hollësi spastrimin etnik të një kombi e të një populli që prej shekujsh jetonte në trojet e veta, e që përfshinte në faqet e atij plani aktet më monstruoze, deri vrasjen dhe hedhjen në zjarr të fëmijëve e të grave, pa llogaritur burrat dhe pleqtë.

Shifrat e viktimave të gjenocidit serb ndaj shqiptarëve janë të frikshme, dhe nuk po përmendim krimin tjetër, atë të shpërnguljes masive, e megjithatë shqiptarët ja dolën të mbijetojnë, dhe marsi i vitit 1999 e gjeti Kosovën me 1.7 milion banorë, 93% e tyre shqiptarë. Pikërisht ndaj tyre Miloshevi dhe regjimi i tij fashist filloi dhe realizoi një sulm të egër për ta spastruar Kosovën etnikisht. Dhe ja arriti. Më se 1 milion shqiptarë të Kosovës lanë pas të vranët dhe varret e të parëve, shtëpi e katandi, dhe morën rrugët e botës.

Në Maqedoni, në Mal të Zi, Zvicër e Gjermani e deri në SHBA, dhjetëra kampe refugjatësh pritën kosovarët e tmerruar nga paramilitarët dhe ushtarët kriminelë serbë. Por ajo pritje që iu bë në Shqipëri ishte e jashtëzakonshme. Sigurisht, edhe kampingjet ishin shumë ndryshe nga ato në vendet fqinje dhe atyre të largët, për kushtet e jetesës e për më tepër për trajtimin vëllazëror, ngrohtësinë njerëzore që shqiptarët e dheut mëmë u dhanë vëllezërve të ikur nga tmerret e luftës. Por ajo që habiti botën ishte hapja e dyerve të shtëpive që shqiptarët e bënë me gjithë zemër, duke ndarë me ta jo vetëm atë pak hapësirë ku jetonin vetë, por edhe bukën e gojës e rrobat e trupit. Ka mijëra episode e ngjarje nga më të bukurat, nga më prekëset të asaj mikpritjeje.

Ajo që bënë Kukësi dhe kuksianët, kur në qytetin e tyre të vogël erdhën valë-valë katërqind mijë vëllezër kosovarë, ata pa hezitim u hapën dyert e zemrave e të shtëpive kanat më kanat, është një mrekulli e shpirtit njerëzor dhe karakterit mikpritës e vëllazëror shqiptar. E si të mos mjaftonin ata që morën nëpër shtëpi, u çuan ushqim apo rroba për t'u veshur apo për shtresa e mbulesa edhe



atyre nëpër salla apo kampinge. Unë mund të tregoj për prindërit e mi në Berat, që pasi mbajtën disa ditë dy gra me gjithë fëmijët nga dera e Kryezinjve në Rahovec, nuk lanë të ikte në kamping vjehrrën e tyre, nënë Havanë, por e mbajtën deri sa erdhën djemtë nga Zvicra. Plaka e mirë u bë shoqe e mirë me nënën time, Parizen, dhe kur erdhi dita u ndanë me lot në sy.

Dhe mund të përmend shokun dhe kolegun tonë, Isuf Bramo dhe bashkëshorten e tij, Tatjanën, në Kuçovë, që jo vetëm i mbajtën në apartamentin e tyre të vogël deri sa erdhi dita fatlume që miqtë e tyre nga fshatrat e Prizrenit të ktheheshin në shtëpitë e tyre, por bashkë me ta dërguan edhe djalin e tyre, Eltonin, të siguroheshin

që mbërritën shëndoshë e mirë. E plot ngjarje të tilla. Në Berat autobusët me gra, burra e fëmijë erdhën një mesnatë marsi dhe një pjesë u strehuan ashtu si mundën në mjediset e Shtëpisë së Ushtrakeve.

Të nesërmen filloi ngritja e kampingeve
Në muajin prill, në rrethin e Beratit kishte 13 kampinge me gjithsej 4407 kosovarë të vendosur në 7 kampinge dhe nëpër familjet e qytetit dhe të fshatrave e konkretisht: 604 veta në familjet e qytetit të Beratit, 1010 veta në kampingun e Paranguajt, Dushnik, 490 në kampingun e Kombinatit të Tekstileve, 390 në kampingun e Moravës, Rep. Ush. 5001, 575 në kampingun e Myftinisë, ish-NPD, 50 veta tek Caritasi Uznovë, 53 te Konvikti i Shkollës Bujqësore, 106 veta tek dhomat e sportistëve te Stadiumi “Tomori”, 200 veta në familjet e Urës Vajguore, 124 në fshatrat e komunës Kutalli, 50 në Poshnje, 135 veta në fshatrat e Komunës Velabisht, 200 veta në fshatrat e Komunës Vërtop, 400 veta në Otlak.

Këto shifra dhe kjo shpërndarje flasin vetë dhe besoj se krijojnë një pamje të asaj që ka ndodhur në Berat dhe në gjithë Shqipërinë. Me Luftën e UÇK-së dhe ndihmës vendimtare të NATO-s, bishës naziste të Beogradit iu pre koka dhe, më 11 qershor, Kosova ishte e lirë! Bijtë e bijat më të mirë të atyre trojeve e vaditën me gjakun e tyre pemën e Lirisë dhe tani zëri i Adem e Hamëz Jasharit dhe 56 pjesëtarëve të asaj familjeje legjendare, zëri i Zahir Pajazitit dhe Ismet Jasharit, Kumanovës, i Luan Hajradinajt dhe Astrit Sulit, djaloshit beratas dhe atij tjetrit, Indritit, Ushtar Kavajës, i Antigona Fazllit dhe familjes së Ymer Elshanit e sa e sa të tjerëve, i thërriste të shpërngulurve në atë eksod biblik të ktheheshin. Dhe ata u kthyen duke marrë me vete edhe një copë Shqipëri, një pjesë nga ajo vëlla-pritje dhe bujari që me të drejtë u quajt Legjendare. Berati dhe beratasit ishin dhe janë krenarë që edhe ata e kaluan me dinjitet e përulësi atë provë ku i vuri, bashkë me viset e tjera shqiptare, nga Tropoja në Sarandë.





KOLONEL HYSNI GJERGJI

“SPIDER WEB”

Operacioni “Spider Web” i datës 1 qershor dhe sulmi mbi urën e Krimesë, më 3 qershor 2025, do mbeten data që shënojnë një transformim dhe hyrjen e luftës, në epokën e dronëve të zgjuar dhe autonomë me impakt të dyfishtë. Ukraina si laborator i përgjakshëm i luftës po provon dhe vendos një model të ri lufte asimetrike, ku një vend më i vogël dhe më i dobët ushtarakisht mund të sfidojë një fuqi më të madhe botërore përmes teknologjisë. Si rezultat i sulmeve në tokën ruse, Rusia është e vendosur nën presion për të përmirësuar mbrojtjen ajrore dhe kundër-dronëve, gjë e cila kërkon kohë, burime dhe përshtatje të strukturës ushtarake. Operacioni “Spider Web” si dhe shkatërrimi i urës së Krimesë për të tretën herë, do të shënojë një pikë kthese në luftën moderne, ku përdorimi i dronëve autonomë dhe të fshehtë mund të bëhet një standard në strategjitë ushtarake të së ardhmes. Ky sulm ka theksuar rëndësinë e inteligjencës artificiale dhe teknologjisë në zhvillimin e operacioneve ushtarake, duke hapur rrugën për përdorimin e teknologjive të avancuara në fushën e mbrojtjes. Gjeneral Stavidis e quajti operacionin ukrainas të 1 qershorit 2025 si “kalë troje” në tokën ruse, ndërsa CNN e titulloi atë si “Pearl Harbor”-in rus. Sulmi i koduar “Spider web” i Ukrainës ndaj avionëve transportues strategjikë rus në pistë, është një nga operacionet më të guximshme dhe teknologjikisht të avancuara të këtij konflikti dhe, ka shënuar një kthesë të rëndësishme në përdorimin e dronëve autonomë në luftë. Ashtu si sulmi japonez në Pearl Harbor më 1941, edhe Operacioni “Spider Web” u karakterizua nga goditje të menjëhershme dhe të papritura ndaj aseteve strategjike ushtarake, konkretisht (bazat ajrore ruse). Rusia pësoi dëme të rënda, pasi u godit flota ajrore strategjike e Rusisë, ashtu siç u dëmtua marina amerikane në 1941. Efekti psikologjik dhe paniku janë evident, sepse sulmi zbuloi se edhe territori i thellë rus nuk është i paprekshëm, njësoj siç u shokua opinioni amerikan pas Pearl Harbor-it. Operacioni ukrainas u krye përmes infiltrimit të “padukshëm” në brendësi të territorit armik, njësoj si grekët që futën kalin prej druri në Trojë thotë gjeneral Stavidis. Dronët u dërguan të fshehur në kontejnerë të zakonshëm mbi kamionë civilë, duke kaluar nën radarët e mbrojtjes ruse, një përdorim mjeshtëror i maskimit dhe mashtrimit. Sulmi erdhi nga “brenda”, përmes mjeteve që Rusia i konsideronte të padëmshme, duke shkatërruar objektiva të rëndësishëm si pasojë e “hapjes së portave” nga vetë sistemi i saj. Pavarësisht se cilën metaforë zgjedhim, është e qartë se Operacioni “Spider Web” do të hyjë në histori si një nga shembujt më të shkëlqyer të luftës së re me elementë klasikë të mashtrimit strategjik. “Spider web” është një operacion i planifikuar për 18 muaj nga Shërbimi i Sigurisë i Ukrainës (SBU), i mbështetur nga presidenti Volodymyr Zelenskyy. Ky sulm ka përdorur 117 dronë FPV (First-Person View) të fshehur në kontejnerë druri dhe transportuar me kamionë brenda territorit rus. Dronët janë aktivizuar dhe drejtuar përmes rrjetit celular dhe inteligjencës artificiale për të goditur objektiva specifike. Një nga goditjet më të largëta ka ndodhur në bazën ajrore Belaya në Siberi, mbi 4,000 km larg kufirit ukrainas. Operacioni ka synuar pesë baza ajrore ruse: Belaya, Dyagilevo, Ivanovo Severny, Olenya dhe Ukrainka. Janë shkatërruar ose dëmtuar mbi 40 avionë, përfshirë bombat strategjike Tu-95, Tu-22M dhe avionët A-50 të zbulimit. Vlera e dëmeve është vlerësuar në rreth 7 miliardë dollarë, duke dëmtuar rëndë rreth 1/3 e flotës ruse të bombarduesve strategjikë dhe dobësuar aftësinë e Rusisë për të realizuar sulme me raketa me rreze të gjatë. Ky është një nga përdorimet më të avancuara të dronëve autonomë në luftë, duke shënuar një hap të rëndësishëm në zhvillimin e teknologjisë ushtarake.

Ky operacion ka pasur një ndikim të madh në moralin e trupave ruse dhe ka dërguar një mesazh të fortë ndërkombëtar për aftësinë e Ukrainës për të realizuar operacione të sofistikuara brenda territorit të armikut. “Spiderweb” është një shembull i shkëlqyer i përdorimit të teknologjisë moderne në luftë, duke treguar se fuqia ushtarake nuk matet vetëm me numra, por edhe me aftësinë për të përdorur teknologjinë në mënyrë të mençur dhe efektive, si dhe ka shënuar një hap të rëndësishëm në zhvillimin e strategjive të luftës moderne, duke ndryshuar balancën e fuqisë në rajon. Ky sulm i thellë në territorin rus, përfshiu katër baza ajrore strategjike dhe shkatërroi mbi 40 avionë, përfshirë Tu-95, Tu-22M3 dhe A-50. Operacioni u planifikua nga Shërbimi i Sigurisë i Ukrainës (SBU) që nga dhjetori i vitit 2023 dhe u mbikëqyr nga vetë presidenti Volodymyr Zelenskyy. Për realizimin e tij, dronët FPV (First-Person View) u fshehën në kontejnerë të montuar mbi kamionë, të cilët u transportuan në Rusi nga shoferë të pa informuar. Në momentin e duhur, kontejnerët u hapën automatikisht dhe dronët u lëshuan drejt bazave ajrore të Belaya, Dyagilevo, Ivanovo, Olenya dhe Ukrainka, duke shkatërruar avionët që ishin të vendosur në pistë, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në infrastrukturë. Çdo dron kishte një kosto të krahaseshme me atë të një iPhone 16 Pro dhe përdorte inteligjencë artificiale për navigimin autonom dhe njohjen e objektivave. Operacioni shkatërroi rreth 34% të flotës ruse të bombarduesve strategjikë, duke përfshirë avionë që përdoren për lëshimin e raketave dhe bombave me rreze të gjatë veprimi. Vlera e avionëve të shkatërruar është vlerësuar në rreth 7 miliardë dollarë, duke përfshirë avionë si Tu-22M3, Tu-95 dhe A-50. Ky sulm ka detyruar Rusinë të rishikojë vendosjen e sistemeve të saj të mbrojtjes ajrore dhe të zhvendosë avionët më larg nga fronti, duke i bërë ata më të prekshëm ndaj sulmeve të ardhshme ukrainase. Operacioni u realizua pak para rinisjes së bisedimeve për paqe në Stamboll, duke i dhënë Ukrainës një avantazh diplomatik ose atë kartë në munguar gjatë takimit të Zelenskit me Trump në Shtëpinë e Bardhë. Ky veprim ka dërguar një mesazh të fuqishëm

Qershori i Luftës së Re



për aftësinë e Ukrainës për të realizuar operacione të thella dhe të sofistikuara, duke ndikuar në mënyrën se si Rusia dhe aleatët e saj do të planifikojnë veprimet e ardhshme. Operacioni “Spider Web”, ka krijuar efekte të thella psikologjike dhe morale në të dyja palët ndërluftuese: ushtarët ukrainas dhe ata rusë.

Ky operacion tregoi se Ukraina është në gjendje të kryejë sulme të sofistikuara në zemër të territorit rus, gjë që forcon besimin se Rusia nuk është e paprekshme. Përdorimi i teknologjisë moderne (dronë autonomë me AI) i bën ushtarët ukrainas të ndihen pjesë e një ushtrie moderne dhe shkencore. Shkatërrimi i avionëve të cilët më parë janë përdorur për të bombarduar qytete ukrainase (si Kievi, Harkivi apo Odesa) sjell një ndjenjë të thellë të vendosjes së drejtësisë për trupat ukrainase në terren. Suksesi i operacionit përkthehet edhe në rritje të moralit përmes jehonës mediatisht dhe përforcimit të imazhit të forcave të armatosura si efektive dhe të vendosura. Ky është një nga rastet kur një sulm i vetëm strategjik ka ndryshuar perceptimin për balancën e fuqisë, duke rritur bindjen se fitorja nuk është vetëm e mundur, por edhe e afërt. Ushtarët rusë, edhe në zona që më parë ishin konsideruar të sigurta (si Siberia apo arktiku), tashmë e kuptojnë se nuk ka më “zonë të sigurt” nga sulmet ukrainase. Humbja e më shumë se 40 avionëve strategjikë është një humbje e madhe si simbolike ashtu dhe materiale. Si ndodhi që dronët arritën të futeshin në Rusi? Si u planifikua dhe nuk u zbulua? Këto pyetje krijojnë tension dhe mosbesim ndaj kapacitetit zbulues dhe parandalues të shërbimeve të inteligjencës ruse. Ukraina ka treguar se mund të kryejë këtë lloj sulmi, kështu që ushtarët rusë do të jetojnë gjithmonë me frikën e një sulmi tjetër edhe më të sofistikuar, në çdo moment dhe në çdo vend. Operacioni “Spider web” është një fitore jo vetëm taktike dhe strategjike, por edhe psikologjike dhe morale për Ukrainën. Ai ka rritur besimin dhe vendosmërinë e trupave ukrainase dhe njëkohësisht ka ulur moralin dhe vetëbesimin e ushtresë ruse. Efekti i operacionit do të ndihet jo vetëm në fushëbetejë, por edhe në mënyrën se si të dyja palët do të planifikojnë dhe perceptojnë të ardhmen e luftës. Profesionalizmi i Shërbimit të Sigurisë së Ukrainës (SBU) në planifikimin dhe ekzekutimin e Operacionit “Spider web” është i jashtëzakonshëm dhe përbën një precedent të ri në mënyrën si zhvillohen operacionet speciale në kohët moderne. Operacioni nisi të planifikohet që në dhjetor 2023 dhe u mbajt plotësisht sekret për më shumë se një vit. Përdorimi i infrastrukturës civile (kamionë të zakonshëm me kontejnerë të modifikuar) dhe shoferë që nuk e dinin çfarë transportonin, tregoi nivel të lartë të maskimit operacional. SBU identifikoi objektiva strategjikë që kishin vlerë të jashtëzakonshme ushtarake (bazat me avionët bombardues Tu-95, Tu-22M3 dhe avionët A-50 të zbulimit ajror). Koordinimi i sulmit ndaj disa bazave në të njëjtën kohë kërkon një nivel të lartë të koordinimit dhe të saktësisë së inteligjencës.

Integrimi i dronëve autonomë të bazuar në AI, të cilët mund të njihnin objektivat pa mbështetje direkte njerëzore në fushëbetejë, tregon se SBU është në pararojë të përdorimit të teknologjisë në operacionet speciale. Sulmi u realizua me befasi totale, gjë që është shenjë e profesionalizmit ekstrem. Asnjë shërbim rus nuk arriti të identifikonte përgatitjet, edhe pse operacioni përfshinte lëvizje të mëdha logjistike në territorin e Rusisë. Drejtimi nga SBU, ka shumë mundësi me mbështetje nga partnerë ndërkombëtarë, tregon aftësi të larta koordinimi mes agjencive të inteligjencës.

